



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR MAT

VENDIM

Nr.5 , datë 17/09/2025

PËR

MOSMIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
NËNTOKËSOR PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT “KLEIT
MARVI” SH.P.K., ME VENDNDODHJE: FUSHË MILOT, NJËSIA
ADMINISTRATIVE MILOT, BASHKIA LEZHË.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Mat,

KONSTATOI SE:

1. Shoqëria “Kleit Marvi” sh.p.k ka aplikuar në sistemin elektronik “Aplikim për përdorim burimi ujor” me Nr. AN021220240006, datë 02.12.2024, duke paraqitur “Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale” me vendndodhje: Fushë-Milot, Njësia Administrative Milot, Bashkia Kurbin, Qarku Lezhë. Në vijim, në zbatim të parashikimeve ligjore Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ka ndjekur procedurën e bashkërendimit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor të aplikimit referuar VKM-së 550, datë 15.7.2020 dhe përgatiti materialin e nevojshëm për shqyrtim në mbledhjen e radhës KBL Mat.
2. Mbledhja e radhës së KBL Mat u zhvillua në datën 19.06.2025 ku kërkesa e subjektit është në shqyrtim u shty se gjatë shqyrtimit anëtarët konstatuan se; subjekti Kleit Marvi është me NIPT tjetër dhe me administrator dikë tjetër. Në vitin 2025 ka ndryshuar pronari dhe ky subjekt duhet të bëjë transferimin e lejes, pra nga ana e anëtarëve u kërkuar të saktësohej NIPT i subjektit.

3. Mbledhja pasardhëse e KBL Mat u zhvillua në datë 17.09.2025, dhe pas shqyrtimit të kërkesës së subjektit për marrjen e lejes së përdorimit të burimit ujor rezultoi se:
4. Nga mbledhja e datës 19.06.2025 u la detyrë që të saktësohej NIPTI i subjektit për këtë arsye ZABL Ishëm-Erzen-Mat kreu monitorimin të subjektit në terren në datë 08.09.2025. Nga monitorimi u konstatua se subjekti kishte ndryshuar NIPT-in e mëparshëm dhe me NIPT-in e ri ka aplikuar për lejen e ujit. Leja Mjedisore ishte me NIPT-in e vjetër. Kompania kishte bërë kërkesë për transferimin e lejes mjedisore dhe ishte akoma në proces. Përveçse, sa u rendit më sipër është për t'u theksuar fakti se, gjatë monitorimit që u krye nga ZABL u evidentuan prani të inerteve lumore ndërkohë që subjekti ka vënë në dispozicion kontratë për gurë gëlqerorë me subjektin "Lleshi" dhe e gjithë veprimtaria zhvillohej me inerte lumore dhe teknologjia e përdorur ishte për inerte lumore. Makineritë ishin në process për larjen e inerteve lumore. ZABL njohu Këshillin me këtë konstatim, për arsye se aplikimi është mbështetur në deklarinimin e subjektit që do të përdori vetëm inerte malore, dhe se të gjitha skemat behën të pa vlefshme pasi nuk është e njëjta skemë për inerte malore dhe për inerte lumore.
5. Rezultoi se subjekti ka qënë objekt kontrolli dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Dibër Shkodër Lezhë dhe nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument institucionit.
6. Në lidhje me dokumentin e pronësisë u ngrit pretendimi se pusi bie jashtë prone, dhe subjekti ka sqaruar vetëm se kjo është si pasojë e azhornimit, por pa vënë në dispozicion ndonjë dokumentacion që të provojë këtë fakt.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Basenit Lumor Mat, bazuar në Kreun IV, pika 1, gërma "ç", të VKM-së nr.319 datë 11.06.2025, dhe në Vendimin nr.6, datë 12.06.2019, "*Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujor*", të Këshillit Kombëtar të Ujit,

V E N D O S I:

1. Mosmiratimin e kërkesës për leje përdorimi uji nëntokësor për qëllime industriale subjekti "Kleit Marvi" sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbytjes së vendimit subjektit.

KRYETAR

TAULANT MALSHI

